

VENDIM
Nr. 696, datë 21.11.2018

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË VENDIMIN NR. 634, DATË 1.10.2014, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE PËR VLERËSIMIN DHE DHËNIEN ME KONCESION/PARTNERITET PUBLIK PRIVAT TË PUNËVE PUBLIKE DHE SHËRBIMEVE PËR NDËRTIMIN, OPERIMIN, MIRËMBAJTJEN DHE REHABILITIMIN E RRUGËVE NACIONALE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5, pikat 1, shkronja “j”, dhe 2, të ligjit nr. 125/2013, “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në tekstin bashkëlidhur vendimit nr. 634, datë 1.10.2014, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, “Rregullat për vlerësimin dhe dhënien me koncesion/partneritet publik privat të punëve publike dhe shërbimeve për ndërtimin, operimin, mirëmbajtjen dhe rehabilitimin e rrugëve nacionale”, bëhen ndryshimet dhe shtesat si më poshtë vijon:

a) Pika 1, e nenit 14, ndryshohet si më poshtë vijon:

“1. Nëse propozimi i pakërkuar konsiderohet i pranueshëm, autoriteti kontraktor mund të nisë procedurën për dhënien e kontratës nëpërmjet një procesi transparent dhe konkurrues.”.

b) Neni 15 riformulohet me këtë përmbajtje:

“Neni 15

Dhënia e bonusit

Në rast pranimi të një propozimi të pakërkuar, përpara procedurës konkurruese propozuesi ka të drejtë të përfitojë nga autoriteti kontraktor, i cili vendos për një nga format e mëposhtme të bonusit:

a) Një bonus për rezultatin tekniko-financiar të propozuar prej tij, deri në një maksimum prej 10% (të 100 pikëve në total) të vlerësimit maksimal të garës, që miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave;

b) Aplikimin e procedurës me publikim të projektit të tij, me qëllim përfitimin e ofertës më të leverdisshme ekonomike, pa ndryshuar projektin teknik.”.

c) Pas nenit 15 shtohet neni 15/1, si më poshtë vijon:

“Neni 15/1

Aplikimi i procedurës me publikim të projektit

1. Në rastin e aplikimit të procedurës sipas përcaktimit të shkronjës “a”, të pikës 1, të nenit 15, më lart, autoriteti kontraktor, pas vendimit për dhënien e kontratës, publikon projektin e propozuesit, me qëllim që të përfitojë ofertën më të leverdisshme ekonomike.

2. Autoriteti kontraktor publikon projektin e propozuesit së bashku me ofertën financiare dhe fton operatorë të tjerë ekonomikë, nëpërmjet një procesi transparent dhe konkurrues të paraqesin propozimet e tyre sipas përcaktimeve në dokumentet e procedurës konkurruese.

3. Oferta më e leverdisshme ekonomike do t'i paraqitet propozuesit me qëllim paraqitjen e një oferte më të leverdisshme ekonomike sesa oferta fituese.

4. Nëse propozuesi pranon, atëherë ai shpallet fitues i garës dhe vijohet më tej për negociimin e kontratës.

5. Nëse propozuesi nuk pranon të paraqesë një ofertë ekonomike më të leverdisshme, atëherë ofertuesi fitues do t'i paguajë atij vlerën e hartimit të projektit teknik, e cila do të publikohet në

dokumentet e procedurës konkurruese.

6. Nëse palët dështojnë në negociimin e kontratës, atëherë ofertuesit do t'i mbahet vlera e garancisë së ofertës dhe do të ftohet propozuesi për negociim sipas vlerës fillestare të propozimit të tij.”.

ç) Në aneksin 1, “Dokumentet standarde të koncesionit/partneritetit publik privat të punëve publike dhe shërbimeve, për ndërtimin, operimin, mirëmbajtjen dhe rehabilitimin e rrugëve nacionale”, të përmendur në nenin 24, emërtimi i shtojcës 4 riformulohet në “Formulari i ofertës financiare/ekonomike”.

2. Ky vendim nuk zbatohet për propozimet e depozituara pranë Autoritetit Kontraktor, për të cilat është marrë një vendim për leverdisshmërinë e tyre përpara hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Edi Rama